VENDIM
Nr. 835, datë 28.10.2020

PËR RREGULLAT PËR PËRMBAJTJEN, FORMËN E REGJISTRIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E ORGANEVE PUBLIKE APO SUBJEKTEVE, QË KANË TË DREJTË QASJEN NË INFORMACIONIN E TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 33, të ligjit nr.34/2019, "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për përmbajtjen, formën e Regjistrit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, në vijim RPSK, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij.
2. RPSK-ja mbahet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, në vijim "AAPSK", në varësi të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
3. Pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar, dhe Kodit të Procedurës Penale, mbahen në këtë regjistër.
4. Miratimin e formatit të të dhënave RPSK, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Të dhënat për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara hidhen në RPSK elektronikisht nga administratori i pasurisë nëpërmjet llogarisë së tij.
6. Të dhënat hidhen që në momentin e marrjes në dorëzim nga protokolli i AAPSK-së të:
a) urdhrit të prokurorit që ka vënë në ekzekutim vendimin e gjykatës për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurive, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar;
b) urdhrit të prokurorit që ka vënë në ekzekutim vendimin e gjykatës që ka miratuar sekuestron preventive dhe/ose konfiskimin e pasurive në zbatim të Kodit të Procedurës Penale.
7. Të dhënat për pasurinë që hidhen në RPSK, janë, si më poshtë vijon:
a) emërtimi i plotë i pasurisë;
b) subjekti:
i. individ (gjenealitetet dhe numri i kartës së identitetit);
ii. person juridik (tregtar apo OJF, shoqëruar me numrin unik të identifikimit NUIS).
c) lloji i pasurisë:
i. pasuri e paluajtshme;
ii. pasuri e luajtshme;
iii. llogari bankare;
iv. shoqëri tregtare, kuotat apo aksionet e shoqërisë.
ç) statusi i pasurisë:
i. sekuestruar;
ii. konfiskuar;
iii. revokuar;
iv. rikuperuar.
d) sasia dhe vlera e përafërt e saj;
dh) numri i protokollit të ardhjes së urdhrit të prokurorit dhe vendimit gjyqësor në AAPSK;

e) numri dhe data e urdhrit të prokurorit që ka vënë në ekzekutim vendimin gjyqësor të AAPSK-së;

ë) numri dhe data/viti i regjistrimit të çështjes penale ose hetimit pasuror, si dhe prokuroria e rrethit gjyqësor përkatës;

f) numri dhe data e dhënies së vendimit të gjykatës dhe veprat penale për të cilat është vendosur sekuestrimi/konfiskimi i pasurisë;

g) gjykata.

8. Të dhënat për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara hidhen në RPSK sipas llojit dhe statusit, në përputhje me rendin kronologjik të vendimit, kur ai përmban disa pasuri.

9. Pasuritë e përcaktuara në pikën 6, të këtij vendimi, ndahen në:

a) pasuri të paluajtshme:

i. njësi (ndërtesa) me destinacion tregtar dhe/ose industrial;

ii. njësi (ndërtesa) me destinacion strehimi dhe/ose përdorim kolektiv;

iii. njësi banimi;

iv. truall ndërtimi;

v. toka bujqësore;

vi. kullota;

vii. pyje;

viii. toka pa frute;

ix. të drejtat reale me objekt sende të paluajtshme.

b) pasuritë e luajtshme, të regjistruara në regjistra publikë;

c) pasuritë e luajtshme dhe shumat monetare, të regjistruara pranë institucioneve financiare ose subjekte të licencuara nga organet përkatëse shtetërore për ruajtjen e tyre;

ç) pasuritë dhe kuotat e aksionet e shoqërive tregtare, të regjistruara në regjistrin e shoqërive tregtare.

10. Në përputhje me veprimet që kryhen mbi pasurinë hidhen të dhënat në vazhdimësi që mbas marrjes në administrim deri në konfiskimin e plotë të saj apo revokimin. Këto të dhëna kanë të bëjnë me:

a) datën e marrjes nën administrim të pasurisë;

b) vlerësimin mbi përputhshmërinë e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, sipas gjendjes reale dhe vendimit të gjykatës;

c) vlerën në treg të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar;

ç) krijimin e të ardhurave nga qiraja dhe interesat bankare, si dhe vlerën e tyre;

d) shpenzimet që kryhen për miradministrimin e tyre, në përputhje me përcaktimin në udhëzimin e ministrit përgjegjës;

dh) vendimet gjyqësore në vazhdimësi të procesit.

11. Në përputhje me të dhënat e hedhura në RPSK nxirren raportet periodike apo statistikat mbi parashikimet e pikave 6, 7 dhe 8, të këtij vendimi, si dhe statusit të pasurisë së konfiskuar e të sekuestruar.

12. Me mbylljen e procesit, kur vendimi gjyqësor ka marrë formën e prerë dhe pasuria është revokuar, në RPSK vendosen, si më poshtë vijon:

a) numri dhe data e dhënies së vendimit;

b) gjykata që ka dhënë vendimin;

c) numri dhe data e urdhrit të prokurorit për ekzekutimin e vendimit;

ç) vendimi gjyqësor;

d) të ardhurat dhe shpenzimet e krijuara nga administrimi i pasurisë;

dh) data e revokimit.

13. Me mbylljen e procesit, kur vendimi gjyqësor ka marrë formën e prerë dhe pasuria është konfiskuar, në RPSK vendosen, si më poshtë vijon:

a) numri dhe data e dhënies së vendimit;

b) gjykata që ka dhënë vendimin;

c) numri dhe data e urdhrit të prokurorit për ekzekutimin e vendimit;

ç) vendimi gjyqësor;

d) të ardhurat dhe shpenzimet e krijuara nga administrimi i pasurisë;

dh) destinacioni përfundimtar i saj, në bazë të urdhrit të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

14 Institucionet që kanë të drejtë marrjen e informacionit në RPSK janë, si më poshtë vijon:

a) ministri dhe sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike ose të autorizuarit prej tyre;

b) të autorizuarit e Prokurorisë së Përgjithshme;

c) të autorizuarit e Prokurorisë së Posaçme;

ç) të autorizuarit e ministrit përgjegjës për drejtësinë;

d) të autorizuarit e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

dh) të autorizuarit e Drejtorisë së Shërbimit Informativ të Shtetit.

15. Institucionet e autorizuara sipas pikës 14, të këtij vendimi, kanë të drejtë të marrin informacion të drejtpërdrejtë apo statistika raportuese, por pa të drejtën e ndërhyrjes në RPSK për ndryshimin e tyre.

16. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

Dokument për formatin e regjistrimit të të dhënave

Përmbajtja

1. Përmbledhje e sistemit dhe të dhënave
1.1 Regjistri i bazave të të dhënave
1.2 Kërkesat dhe rregullat për administrimin e të dhënave
1.3 Dhënësi/dhënësit e informacionit
1.4 Të dhënat parësore
1.5 Të dhënat dytësore
1.6 Bazat e të dhënave me të cilat ndërvepron sistemi
2. Arkitektura e sistemit dhe bazës së të dhënave
2.1 Objektet e aksesit të të dhënave
2.2 Ndërfaqet dhe modulet e sistemit

1. Përmbledhje e sistemit dhe të dhënave

Sistemi i administrimit të pronave të sekuestruara dhe konfiskuara i mundëson punonjësve të AAPSK të realizojnë procesin e menaxhimit dhe dhënies me qira të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara në mënyrë automatike. Objektivat e këtij sistemi janë:

- regjistrimi dhe monitorimi e të gjithë objekteve të sekuestruara dhe të konfiskuara të dhëna me qira;
- ndjekja e proceseve të punës në lidhje me pasuritë e menaxhuara nga AAPSK-ja;
- gjurmimi i kontratave për marrjen me qira të objekteve të sekuestruara dhe të konfiskuara;
- krijimin e një baze të dhënash me info të përgjithshëm për të gjitha pronat e sekuestruara dhe të konfiskuara.

1.1 Regjistri i bazave të të dhënave

Emërtimi bazës së të dhënave	SPSK (Sistemi i pronave të sekuestruara dhe të konfiskuara)
Emërtimi shkurt i bazës së të dhënave	SPSK

1.2 Kërkesat dhe rregullat për administrimin e të dhënave

Të dhënat që përdoren në sistemin e administrimit të pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara janë të regjistruara në një bazë të dhënash, e cila aksesohet nëpërmjet sistemit nga përdorues me role të ndryshme. Rolet kryesore që aksesojnë sistemin dhe të drejtat e tyre janë:

- Administratori qendror

Realizon të gjitha konfigurimet e nevojshme për funksionimin e sistemit, si: konfigurimi i organigramës, përdoruesve, statuseve të pasurive, institucionet, njësitë matëse, llojet e llogarive.

- Kryeadministratori

Realizon shpërndarjen e pasurive në administratorët përkatës në bazë të urdhrit të ardhur ose vendimit të tij. Merret me koordinimin e punës dhe mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave që lidhen me administrimin e pasurive nga administratorët.

- Administratori i pasurisë

Është personi që është caktuar me vendim gjykate për administrimin e pasurisë së sekuestruar/ konfiskuar ose me urdhër të brendshëm të Kryeadministratorit. Ndjek të gjitha procedurat e nevojshme për menaxhimin e pasurive që i janë caktuar.

- Koordinatori i terrenit

Ndjek dhe koordinon punën për marrjen në administrim të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Kontrollon raportet mujore dhe tekniko-financiare të gjeneruara. Kontrollon dhe mbikëqyr statusin e pasurive në administrim të AAPSK-së.

- Koordinatori juridik

Ndjek dhe koordinon punën për marrjen në dorëzim të pasurisë nga administratori i pasurisë i caktuar. Monitoron kontratat e qirasë së regjistruara në sistem nga administratorët e pasurive dhe akseson raportet e gjeneruara në sistem në lidhje me pasuritë e dhëna me qira.

- Koordinatori financiar

Gjeneron raporte dhe statistika financiare që kanë të bëjnë me të ardhurat dhe shpenzimet e pasurive në administrim nga AAPSK-ja. Mbikëqyr raportimet e realizuara nga administratorët mbi të ardhurat dhe shpenzimet e kryera për pasuritë.

1.3 Dhënësi/dhënësit e informacionit

Më poshtë gjenden dhënësit e informacionit për këtë sistem:

Qytetarë	Biznese	Administratë
		Administratorët e pasurive – regjistrimi i të dhënave
		ZRPP, DPGJC, DPSHTRR, QKR – Komunikim nëpërmjet webservice

1.4 Të dhënat parësore

Të dhënat parësore janë informacione specifike, të mbledhura nga institucioni administrues, në përputhje me aktin e krijimit. Këto të dhëna listohen si më poshtë:

Numri	Të dhënat
1	Pasuria e sekuestruar/konfiskuar (emërtimi)
2	Vendimet gjyqësore
3	Lloji i pasurisë së sekuestruar/konfiskuar
4	Pronari/ pronarët e pasurisë
5	Vlera e tregut të pasurisë

6	Administratori i pasurisë dhe data e marrjes në dorëzim
7	Statusi i pasurisë
8	Sasia dhe njësia e pasurisë
9	Llojet e të ardhurave dhe shpenzimeve
10	Të ardhurat dhe shpenzimet e regjistruara për pasuritë
11	Kontratat e qirasë dhe qiramarrësit
12	Përdoruesit
13	Banka, lloji i llogarisë, interesi (për pasuritë e tipit: llogari)

1.5 Të dhënat dytësore

Të dhënat dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore. Këto të dhëna listohen si më poshtë:

Institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes civile	
Databaza Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile	
Numri	Të dhënat
1	NID
2	Emër
3	Atësi
4	Mbiemër
5	Datëlindje
6	Adresa
Institucioni Qendra Kombëtare e Biznesit	
Databaza Regjistri Tregtar	
Numri	Të dhënat
1	NIPT
2	Emri i subjektit
3	Tipi i subjektit
4	Statusi i subjektit
5	Data e regjistrimit
6	Përfaqësuesi
7	Adresa
8	Aktiviteti i subjektit
Institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	
Databaza Regjistri Kombëtar i Mjeteve	
Numri	Të dhënat
1	NID
2	Targa
3	Lloji i mjetit
4	Nr. Shasie
5	Marka
6	Modeli
7	Ngjyra
8	Viti
Institucioni Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	
Databaza Regjistri Elektronik i Pasurive të Paluajtshme	
Numri	Të dhënat
1	Zonë kadastrale
2	Volum
3	Faqe
4	Nr. i pasurisë
5	Lloji i pasurisë
6	Adresa e pasurisë
7	Pronarët

1.6 Bazat e të dhënave me të cilat ndërvepron sistemi

Këtu paraqiten lidhjet me bazat e tjera të të dhënave duke i ndarë ato si konsumues dhe eksportues informacioni drejt kësaj baze të dhënash.

Eksportues	Konsumues
Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile	SPSK
Regjistri Tregtar	SPSK
Regjistri Kombëtar i Mjeteve	SPSK
Regjistri Elektronik i Pasurive të Paluajtshme	SPSK

2. Arkitektura e sistemit dhe bazës së të dhënave

Më poshtë gjenden skemat për menaxhimin e pronave të sekuestruara dhe menaxhimin e aplikimeve të realizuara për pronat e sekuestruara.



Diagrami 1. Regjistrimi i pasurive



Diagrami 2. Kryeadministratori



Diagrami 3. Menaxhimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara

2.1 Objektet e aksesit të të dhënave

Këtu përshkruhen të gjitha objektet që përdoren për të komunikuar me bazën e të dhënave. Çdo objekt, i cili përfshihet në këtë paragraf, përfaqësohet nga një tabelë ose tabela të cilat e përfaqëson atë në bazën e të dhënave.

Nr.	Emri i tabelës (klasa)	Përshkrimi i tabelës
1	PSK_Adresa	Kjo tabelë ruan adresat e sistemit
2	PSK_Aplikimi_per_qera	Kjo tabelë ruan aplikimet që do të bëhen nga subjektet në frontend për qira të pasurive të publikuara
3	PSK_Bashkia	Kjo tabelë ruan bashkitë për adresat
4	PSK_Dokumenta	Kjo tabelë ruan dokumentet e ngarkuara gjate procesimit të

		pasurive
5	PSK_Dokumenta_Aplikimi_per_qera	Kjo tabelë ruan dokumentet e ngarkuara gjate aplikimit për qira dhe kontratën e qiramarrjes në fund
6	PSK_Dokumenta_pasurie	Kjo tabelë ruan lidhjet e dokumenteve me pasuritë
7	PSK_Emaili	Në këtë tabelë ruhen emailet e përdoruesve et sistemit
8	PSK_Institucionet	Kjo tabelë ruan emrat e institucioneve nga vijnë dokumentet (si gjykata etj.)
9	PSK_Lidhje_kontrate_qera	Kjo tabelë do të ruajë të dhënat e kontratave për qira
10	PSK_Lloj_dokumenti	Kjo tabelë ruan llojet e dokumenteve
11	PSK_Lloj_dokumenti_Status_pasurie	Kjo tabelë ruan lidhjen e dokumenteve të ngarkuara me pasuritë përkatëse
12	PSK_Lloj_llogarie	Kjo tabelë ruan llojet e llogarive monetare
13	PSK_Lloj_pasurie	Kjo tabelë ruan llojet e pasurive
14	PSK_Lloj_shpenzimi_Te_ardhure	Kjo tabelë ruan llojet e shpenzimeve dhe të ardhurave
15	PSK_Njesi_Administrative	Kjo tabelë shërben për ruajtjen e njësive administrative
16	PSK_Njesi_matese	Kjo tabelë ruan njësitë matëse
17	PSK_Njesi_matese_Lloj_pasurie	Kjo tabelë ruan lidhjen e njësive me llojet e pasurive
18	PSK_Organigrama	Tabelë që shërben për ruajtjen organigramës
19	PSK_Organigrama_Role	Kjo është një tabele lidhëse e organigramës me rolet. Shërben për të bërë lidhjen e pozicionit të organigramës me rolet përkatëse.
20	PSK_Pasuri_Lloj_llogarie	Kjo tabelë ruan lidhjen e pasurisë me llojin e llogarisë. Do ruhet gjithë historiku. Duke pasur aktiv do kuptohet kush është lloji aktual i pasurisë (bëhet fjale për llogarite monetare)
21	PSK_Pasuri_Status_pasurie	Kjo tabelë ruan lidhjen e pasurisë me statusin e pasurisë
22	PSK_Pasuri_Status_qeraje	Kjo tabelë ruan lidhjen e pasurisë me statusin e qirasë
23	PSK_Pasurite	Kjo tabelë ruan të dhënat e pasurive
24	PSK_Përdorues	Në këtë tabelë ruhen përdoruesit e sistemit
25	PSK_Përdorues_Adresa	Kjo tabelë ruan lidhjen e personave ose pasurive me adresat
26	PSK_Përdorues_Organigrama	Kjo tabelë ruan lidhjen e përdoruesve me organigramën
27	PSK_Përdorues_Pyetje	Kjo tabelë shërben si lidhëse midis përdoruesve dhe pyetjeve të sigurisë.
28	PSK_Person	Kjo tabelë ruan të dhënat e personave dhe subjekteve
29	PSK_Person_Kontakti	Kjo tabelë ruan personat e kontaktit
30	PSK_Prefekture	Kjo tabelë ruan prefekturat
31	PSK_Pyetje	Kjo tabelë ruan pyetjet
32	PSK_Qarku	Kjo tabelë ruan qarqet
33	PSK_Role	Kjo tabelë ruan rolet
34	PSK_Rruga	Kjo tabelë ruan rrugët
35	PSK_Shpezime_Te_ardhura_Pasurie	Kjo tabelë ruan shpenzimet dhe të ardhurat e pasurive
36	PSK_Shteti	Kjo tabelë ruan shtetet
37	PSK_Status_pasurie	Kjo tabelë ruan statuset e pasurive
38	PSK_Status_qeraje	Kjo tabelë ruan statuset e qirasë
39	PSK_Telefoni	Kjo tabelë ruan telefonat e personave
40	PSK_User_logs	Kjo tabelë ruan loget e userave

2.2 Ndërfaqet dhe modulet e sistemit

Modulet kryesore që ndërveprojnë në sistem janë:

- Moduli i login, profilit dhe sigurisë

Faqet	Funksionalitetet
Logim në sistem	- Logim në sistem i përdoruesve me username dhe fjalëkalim - Logim në sistem i përdoruesve sipas rolit të tyre - Logim në sistem pasi është vendosur kodi i Google authentication nëse është aktivizuar opsioni - Login në sistem pasi është vendosur kodi i ardhur me email nëse është aktivizuar opsioni - Login në sistem nëse është vendosur kodi i ardhur me sms,

	nëse është aktivizuar opsioni - Mundësia e rimarrjes së llogarisë në rast kur është harruar fjalëkalimi në varësi të opsioneve të sigurisë së aktivizuara (Google auth, mail, nr. Cel dhe pyetjet e sigurisë)
Profili i përdoruesit	- Modifikimi i të dhënave personale të përdoruesit - Modifikimi i të dhënave të llogarisë së përdoruesit (username; fjalëkalim) - Editimi i adresave të përdoruesit - Editimi i adresave të emailit të përdoruesit - Editimi i numrave të celularit të përdoruesit - Editimi i numrave të kontaktit të përdoruesit
Aktivizimi i opsioneve të sigurisë	- Aktivizimi i login me Google authenticator - Aktivizimi i login nëpërmjet adresës së email-it - Aktivizimi i login nëpërmjet numrit të celularit - Aktivizimi i pyetjeve të sigurisë për rimarrjen e llogarisë në rast kur janë harruar kredencialet

- Moduli i konfigurimeve të administratorit

Faqet	Funksionalitetet
Konfigurimi i përdoruesve	- Shfaqja e listës së përdoruesve të sistemit - Shfaqja e listës së përdoruesve sipas filtrave - Shfaqja e organigramës që me të cilën do të lidhen përdoruesit - Shtimi i një përdoruesi të ri në sistem - Modifikimi i të dhënave të një përdoruesi në sistem - Fshirja e një përdoruesi nga sistemi - Lidhja e një përdoruesi me pozicionin në organigramë
Konfigurimi i organigramës	- Shfaqja e organigramës në sistem - Shfaqja e pozicioneve të organigramës sipas filtrave - Shfaqja e roleve me të cilët do të lidhet organigrama - Shtimi i një elementi të ri në organigramë - Modifikimi i të dhënave të një elementi në organigramë - Fshirja e një elementi të një organigrame nga sistemi - Lidhja e një organigrame me rolet
Konfigurimi i llojeve të dokumenteve	- Shfaqja e listës së llojeve të dokumenteve - Shfaqja e listës së dokumenteve sipas filtrimit - Shtimi i një lloji të ri dokumenti - Modifikimi i të dhënave të dokumenteve - Fshirja e llojeve të dokumenteve - Pastrimi i fushave kur do të shtohet një dokument i ri
Konfigurimi i statuseve të pasurive	- Shfaqja e listës së statuseve të pasurisë - Shfaqja e listës së statuseve të pasurisë sipas filtrimit - Shtimi i një statusi të ri - Modifikimi i të dhënave të një statusi - Fshirja e statuseve - Pastrim i fushave kur do të shtohet një status i ri
Konfigurimi i lidhjes së statuseve me llojet e dokumenteve	- Shfaqja e listës së statuseve për të cilat do të caktohen dokumentet - Shfaqja e listës së dokumenteve që do të lidhen me statuset e pasurive - Caktimi i një ose me shume dokumentesh për status - Caktimi nëse dokumentet janë të detyrueshëm apo opsionale për një status

	- Heqja e llojeve të dokumenteve nga një status
Konfigurimi i llojeve të shpenzimeve dhe të ardhurave	- Shfaqja e listës së llojeve të shpenzimeve dhe të ardhurave - Shfaqja e llojeve të shpenzimeve/ardhurave sipas filtrimit - Shtimi i një lloji shpenzimi të ri - Shtimi i një lloji të ardhure të re - Modifikimi i të dhënave të një shpenzimi - Modifikimi i të dhënave për llojet e të ardhurave - Fshirja e një lloji shpenzimi - Fshirja e një lloji të ardhure - Pastrim i fushave për shtimin e një të ardhure/shpenzimi të ri
Konfigurimi i gjykatave	- Shfaqja e listës së gjykatave - Filtrimi i gjykatave - Shtimi i një gjykate të re - Modifikimi i të dhënave të një gjykate - Fshirja e një gjykate - Pastrimi i fushave për shtimin e një gjykate të re
Konfigurimi i njësive matëse (në varësi të llojit të pasurisë)	- Shfaqja e listës së njësive matëse në varësi të llojit të pasurive - Shtimi i një njësie matëse të re - Modifikimi i të dhënave të njësisë matëse - Fshirja e një njësie matëse - Pastrimi i fushave për shtimin e një njësie matëse të re
Konfigurimi i llojit të llogarisë	- Shfaqja e listës së llojeve të llogarive - Shtimi i një lloji llogarie të re - Modifikimi i të dhënave të një lloji llogarie - Fshirja e një lloji llogarie - Pastrimi i fushave për llojin e llogarive

- Moduli i regjistrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara

Faqet	- Funksionalitetet
Login në sistem	- Login me kredencialet e përdoruesve në sistem
Regjistrimi i pasurive	- Regjistrimi i të dhënave të vendimit gjyqësor për pasuritë e sekuestruara - Regjistrimi i të dhënave të pasurive të paluajtshme të sekuestruara dhe të konfiskuara - Regjistrimi i të dhënave të pasurive të luajtshme të sekuestruara dhe të konfiskuara - Regjistrimi i pasurive monetare të sekuestruara dhe të konfiskuara - Regjistrimi i të dhënave për bizneset e konfiskuara ose të sekuestruara - Regjistrimi i të dhënave të pronareve (subjekteve/individëve) për këto pasuri

- Moduli i procesimit dhe menaxhimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara

Faqet	Funksionalitetet
Kryefaqja	- Shfaqja e të gjitha pasurive të regjistruara sipas statusit (sekuestruara, konfiskuara, revokuara etj.) - Shfaqja e të gjitha pasurive sipas rolit të përdoruesit (administratorit të pasurisë i shfaqen vetëm pasuritë e tij) - Shfaqja e të gjitha pasurive për të cilat nuk është caktuar një administrator (i shfaqen kryeadministratorit) - Shfaqja e të gjitha pasurive të regjistruara sipas llojit të pasurisë

	- Filtrimi i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara sipas pronareve, numrit dhe datës së vendimit, datës së marrjes në dorëzim. - Renditja e pasurive sipas të dhënave që shfaqen në kryefaqe Hapja e detajeve të pasurisë në momentin kur zgjidhet një pasuri - Mundësia e zgjedhjes së pasurive pa administrator dhe caktimi i një administratori për këto pasuri - Shfaqja e pasurive të cilat janë publikuar për t'u dhënë me qira
Detajet e pasurisë	- Shfaqja e llojit të pasurisë - Shfaqja e vendimeve të marra për atë pasuri, si dhe dokumentet e ngarkuara për vendim (nëse ka) - Shfaqja e datës së marrjes në dorëzim, vlerës së pasurisë dhe administratorit të pasurisë - Shfaqja e pronarit (subjektit ose personit) të pasurisë - Shfaqja e të dhënave të regjistruara për pasurinë në varësi të llojit të pasurisë - Shfaqja e shpenzimeve dhe të ardhurave të realizuara për pasurinë - Mundësia e shtimit të shpenzimeve dhe të ardhurave për pasuri - Mundësia e shtimit të urdhrave gjyqësore për pasurinë - Shfaqja e kontratave të realizuara për një pasuri, si dhe pagesat e kryera të qirasë të lidhura me kontratat - Caktimi i datës së marrjes në dorëzim të pasurisë nga administratori - Ndryshim i statusit të pasurisë
Faqja e menaxhimit të pasurive/aplikimeve me qira	- Shfaqja e të gjitha aplikimeve të realizuara për pasuritë e sekuestruara/konfiskuara që jepen me qira - Mundësia e filtrimit të aplikimeve sipas pasurive, aplikantit, administratorit, llojit të pasurisë.
Faqja e shpenzimeve dhe të ardhurave për pasuri (mund të shfaqen shpenzimet/ardhurat për pasuri dhe t'i shtojë ato)	- Shfaqja e shpenzimeve të realizuara për një pasuri - Shfaqja e të ardhurave të realizuara për një pasuri - Shtimi i një shpenzimi të ri për pasuri - Shtim i një të ardhure të re për pasuri - Modifikimi i të dhënave për shpenzimet e realizuara nga pasuria - Modifikim i të dhënave për të ardhurat e pasurisë - Fshirja e një shpenzimi/të ardhure për pasuri - Filtrimi i shpenzimeve dhe të ardhurave
Faqja e menaxhimit të urdhrave të ekzekutimit për pasuri	- Shfaqja e urdhrave të ekzekutimit të lëshuar për një pasuri - Shtimi i urdhrave të ekzekutimit në lidhje me një pasuri - Modifikimi i urdhrave të ekzekutimit për një pasuri - Fshirja e një urdhri ekzekutimi për pasuri

- Moduli i raporteve të gjeneruara nga sistemi

Raport mbi loget e përdoruesve	- Shfaq listën e logeve të përdoruesve që janë loguar me sukses - Shfaq listën e logeve të përdoruesve që nuk janë loguar me sukses - Shfaq listën e logeve të daljes së përdoruesve nga sistemi - Mundësi filtrimi sipas intervalit të datave, llojit të logeve dhe përdoruesve

Raport në lidhje me të dhënat e pronave të sekuestruara dhe të konfiskuara	- Shfaqja e listës së pronave të sekuestruara dhe të konfiskuara ku të shfaqen informacionet bazë të pronës, si: vendndodhja, sipërfaqja, vlera - Shfaqja e listës së pronave të sekuestruara dhe konfiskuara sipas llojit të pasurisë - Filtrimi i listës së pronave të sekuestruara dhe të konfiskuara sipas kritereve të kërkimit
Raport në lidhje me statusin e pronave të sekuestruara dhe të konfiskuara	- Shfaqja e listës së pronave të sekuestruara dhe të konfiskuara sipas statusit dhe vlerës - Filtrimi i listës së pronave sipas kritereve të kërkimit
Raport mbi monitorimin e pronave të dhëna me qira	- Shfaqja e statistikave mbi pronat e sekuestruara/konfiskuara të dhëna me qira - Shfaqja e statistikave mbi pronat e konfiskuara dhe të sekuestruara sipas statusit të qirasë - Filtrimi i listës së pronave sipas kritereve të kërkimit
Raportet e të ardhurave dhe shpenzimeve	- Shfaqja e listës së të ardhurave dhe shpenzimeve për pronat e kërkuara - Shfaqja e pronave me të ardhurat dhe shpenzimet totale të realizuara për pronë - Filtrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të pronave sipas kritereve të kërkimit